



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA SUPREME**

---

Numri i lëndës: 2022:041507

Datë: 07.12.2022

Numri i dokumentit: 03722073

ARJ nr.102/2022

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË – kolegji i përbërë nga gjyqtarët; Ragip Namani, kryetar, Nebojša Boričić dhe Erdogan Haxhibeqiri, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional, Sherif Krasniqi, procesmbajtës, në çështjen juridike në konflikt administrativ sipas padisë së paditësit-propozuesit, S. Ll. nga P., kundër të paditurit, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës në Prishtinë,(KPMShCK), me bazë juridike anulim i vendimit të paditurit, nr. 1215/21 të dt. 04.02.2022, dhe kërkesë për shtyrjen e ekzekutimit të njëjtit, duke vendosur lidhur me kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor të paditësit-propozuesit, kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit-Departamenti për Çështje Administrative në Prishtinë, AA. nr. 507/2022 të datës 18.07.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë, 01 Dhjetor 2022, merr;

**A K T V E N D I M**

Refuzohet e pa bazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor e parashtruar nga paditësi, S. Ll., kundër aktvendimit të Gjykatës së Apelit-Departamenti për Çështje Administrative në Prishtinë, AA. nr. 507/2022 të datës 18.07.2022.

**A r s y e t i m i**

Me aktvendimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit-Departamenti për Çështje Administrative Prishtinë, AA. nr. 507/2022 të datës 18.07.2022, është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësit-propozuesit, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A nr.429/2022 i datës 23.05. 2022, vërtetohet.

Kundër aktvendimit të lartë cekur të Gjykatës së Apelit, në afat ligjor në Gjykatë Supreme, paditësi parashtron kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor me të cilën e konteston ligjshmërinë e të njëjtit për shkak të; shkeljes së dispozitave të Ligjit për Konflikte Administrative Propozon që kërkesa e paditësit të aprovohet ndërsa të anulohet aktvendimi i Gjykatës së Apelit, AA nr. 507/2022 i dt. 18.07.2022, dhe çështja të kthehet në rivendosje.

Gjykata Supreme në përputhje me nenin 53 të LKA-së, në seancën e mbajtur, vlerësoi pretendimet e paraqitura në kërkesë, ekzaminoi aktvendimin e kontestuar të gjykatës së shkallës së dytë dhe atë të shkallës së parë dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të tjera të lëndës gjen se;

Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se, me aktvendimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit, është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësit-propozuesit, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, A nr. 429/2022 i dt. 23.05.2022, vërtetohet, me të cilin është refuzuar si e pabazuar kërkesa-propozimi i paditësit, për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit nr. 1215/21 të datë 04.02.2022, lëshuar nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës i Shërbimit Civil të Kosovës me seli në Prishtinë, deri në vendosjen e çështjes sipas padisë.

Me nenin 22 të Ligjit për Konfliktet Administrative parashihet se, me kërkesën e paditësit-ses akti i organit i cili ekzekutohet, gjegjësisht organi që është kompetent për ekzekutim, mund ta shtyjë ekzekutimin deri në vendimin definitiv gjyqësor, nëse ekzekutimi i aktit administrativ do të sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja nuk do të sillte ndonjë dëm palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar. Ndërsa me dispozitën e nenit 22 paragraf 6, të njëjtit ligj përcaktohet se, paditësi mund të kërkoj edhe nga gjykata shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ deri në marrjen e vendimit gjyqësor, sipas kushteve të parapara në paragrafin 2 të këtij neni.

Kolegji i kësaj gjykate bazuar në dispozitën ligjore të cituar si më lartë duke shqyrtuar kërkesën e paditësit, vendimin e atakuar të Gjykatës së Apelit dhe atë të shkallës së parë gjen se, gjykatat e instancave më të ulëta, kanë vendosur drejtë dhe në baza ligjore si në aktvendimet e tyre të apeluara, me refuzimin kërkesës-propozimit të paditësit nga gjykata e shkallës së parë, dhe ankesës nga Gjykata e Apelit, si të pa bazuar për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të organit të paditur, të KPMSHCK, me nr.1215/21 të datës 04.02.2022, deri në vendosjen meritore të çështjes me vendim përfundimtar gjyqësor. Qëndrimin juridik të Gjykatës së Apelit si të rregullt, të drejtë dhe ligjor në tërësi e aprovon edhe kjo gjykatë me që aktvendimi i kontestuar nuk është i përfshirë me shkelje të dispozitave të Ligjit për Konflikte Administrative si pretendon paditësi në kërkesë.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate paditësi nuk arrin të dëshmojë me prova bindëse në mbështetje të kërkesës së tij, se me ekzekutimin e vendimit të organit administrativ do të shkaktohej dëm i cili vështirë do të riparohej, që shtyrja-pezuillimi i ekzekutimit të vendimit të kontestuar nuk është në kundërshtim me interesin publik, dhe që shtyrja nuk do të shkakonte dëm të pa riparueshëm apo të madh palës kundërshtare-kundër propozuesit, përkatësisht palës së interesuar. Pra në çështjen juridike konkrete nuk janë plotësuar kushtet ligjore si parashihen në nenin 22 të LKA-së në mënyrë kumulative të cilat janë të domosdoshme që pastaj gjykata të nxjerrë vendim për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të organit administrativ të paditur gjer në vendosjen meritore të çështjes sipas padisë me vendim të plotfuqishëm gjyqësor.

Pretendimet në kërkesë të paditësit ashtu si u theksua më lartë, dhe theksimet ndër të tjera në arsyetim të saj se, gjykata e shkallë së parë duke vendosur në ri procedurë ka nxjerrë aktvendim të njëjtë si më parë i cili ishte anuluar nga gjykata e shkallës së dytë, se dëmi që i shkaktohet paditësit nuk do provë tjetër nga faktet e ofruara në padi sepse përzgjedhja e kandidatit që nuk i plotëson kushtet ligjore të konkursit dhe eliminimi i propozuesit nënkupton dëmin të pa riparueshëm sepse i njëjti nuk mund të merr pozitën e merituar dhe nuk mund të realizoj pagën sipas kushteve të konkursit, si dhe theksimet e tjera në këtë drejtim që kanë të bëjnë me kontestimin e ligjshmërisë së vendimit të organit të paditur, kolegji i Gjykatës Supreme i shqyrtoi në tërësi në baza ligjore dhe i vlerëson se nuk janë të qëndrueshme, sepse kanë të bëjnë me shumë lidhur me çështjen kryesore, kontestimin e ligjshmërisë së vendimit të organit të paditur të KPMSHCK dhe të organit punëdhënës me përzgjedhjen e kandidatit tjetër. Nuk qëndrojnë edhe pretendimet e tjera se, nga ekzekutimi i vendimit për përzgjedhje e deri në anulimin eventual të tij duhet paguar pagën kandidatit të përzgjedhur dhe me këtë do të dëmtohej paraja publike sepse do të paguheshin dallimet në pagë dhe dy persona për pozitën e njëjtë dhe dëmet do të bien në barrë të palës së interesuar të KPK, etj, sepse si do që të vendoset çështja në procedurë të rregullt gjyqësore gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit të organit të paditur, me që bëhet për kompensim në mjete monetare, dëmi do të ishte i riparueshëm, çoftë në mënyrë të kompensimit, dëmshpërblimit apo rimbursimit, sipas bazave ligjore. Prandaj sipas theksimeve në kërkesë nuk dëshmohet se me ekzekutimin e vendimit të organit të paditur të KPMSHCK, të kontestuar me padi që paditësit do ti shkaktohej dëm i cili vështirë do të riparohej ashtu si parashihet në nenin 22 par.2 dhe 6 të LKA-së, gjer në vendosjen meritore të çështjes.

Pretendimet se vendimi i organit të paditur është kundërligjor, nuk mund të pranohet si provë dhe të shqyrtohet në këtë fazë të vendosjes për masë të përkohshme, për deri sa ligjshmëria e tij shqyrtohet në procedurë të rregullt gjatë vendosjes meritore të çështjes kryesore dhe shqyrtimit të provave sipas padisë së paditësit. Prandaj pretendimet në këtë drejtim nuk janë me ndikim për vendosjen ndryshe të kësaj çështje, nga ajo e vendosur si në vendimin e gjykatës së shkallës së dytë, i cili është i drejtë ligjor dhe i arsyetuar mjaftueshëm bazuar në faktet vendimtare për aq sa është e domosdoshme të arsyetohet mënyra e vendosjes për masë të përkohshme sipas provave të ofruara nga paditësi ashtu si parashihet në nenin 22 të LKA-së, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë edhe për faktin se që mënyra e vendosjes për masë të përkohshme dhe arsyetimi i vendimmarrjes të mos e prejduktoj mënyrën e vendosjes së çështjes kryesore sipas padisë.

Nga parashtrimet si më lartë dhe në bazë të nenit 54, par.1, lidhur me nenin 22, par.2 dhe 6, të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË  
ARJ nr. 102/2022, me datë 01 Dhjetor 2022

Procesmbajtës,  
Sherif Krasniqi

Kryetari i kolegjit,  
Ragip Namani